UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

DEPARTAMENTI I PUNËS DHE POLITIKAVE SOCIALE

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

ETIKA DHE PROFESIONI

"Çështjet etike"

Punoi: Rigena Kurpali

Master shkencor

Administrim i shërbimeve sociale, viti II

Tiranë 2021

Çështjet etike në organizata kanë marrë vëmendje viteve të fundit për një sërë arsyesh si rritja e përbuzjes publike, cinizmi i menaxherëve si dhe konflikti i brendshëm i vlerave personale-profesionale. Etika në një kërkim të zhvilluar është përkufizuar si "parimet e drejta dhe të gabuara që një pjesë e grupeve i pranon". Kodet etike të kërkimit adresojnë të drejtat individuale drejt dinjitetit, privatësisë, konfidencialitetit dhe advokacisë.[1] Në çdo profesion hasen shpesh çështje etike, të cilat profesionistët e fushave të ndryshme duhet të tregohen shumë të kujdesshëm për adresimin e tyre në mënyrë që të marrin zgjidhje. Kuptimi i stadeve të zhvillimit konjitiv mund të përdoret për të karakterizuar stadet e arsyetimit të menaxherëve bazuar në çështjet etike në organizata. Edukimi i lartë është i rëndësishëm në zhvillimin profesional.[2] Kur një situatë përfshin etikën, por nuk mendohet që ka përgjegjësi, atëherë kemi të bëjmë me çështje etike.

Fakti nëse një çështje etike është një përgjegjësi etike apo një dilemë etike, mbetet në diskutim. Ky fakt është konkluduar për vite të tëra në kurset e mësimit të etikës profesionale, duke vënë në pah një rast konkret të edukatorëve që nuk arrijnë të bëjnë diferencën mes përgjegjësisë etike dhe dilemës etike por as nuk e dijnë se si këto të dyja mund të përfshihen.

> *"Në rastin e një fëmije që refuzon të konsumojë ushqimin e mëngjesit në kopësht, si dhe shfaq ankth në momentin që edukatorja i bën me dije se do njoftojë prindërit, ndërkohë që prindërit insistojnë që edukatorja ta binë fëmijën që ta konsumojë vaktin."*

Në këtë rast edukatorja nxjerr në pah një çështje etike, pra është mes përgjegjësisë etike ndaj dy palëve. Si fillim, i rekomandohet të përcaktojë natyrën e problemit, duke e shqyrtuar nëse është një çështje etike apo nëse ka përgjegjësi dhe si do e gjej edukatorja një zgjidhje të mesme për të dy palët. Më pas, merren parasysh përgjegjësitë etike, idetë për çdo zgjidhje të mundshme, si dhe prekja e

---

[1] Bogdan & Biklen, 1992, p.49
[2] Kohlberg's Stages, 1973.

nevojave të të dy palëve.[3]

Më tej, edhe natyra komplekse e këshillimit krijon mundësi që të rritet numri i çështjeve etikë në këshillim.[4] Bazuar në një artikull që trajton çështjet etike në këshillim, nxjerr në pah çështjen etike që has këshilluesi në një shkollë fillore. Konkretisht mund të sjellim si shembull, çështjet etike në konsultim, pra raportin e një mësuesi në një shkollë me këshilluesin. Si rezultat i sjelljes së një nxënësi kundrejt bindjeve të mësuesit, ndërhyrja e këshilluesit bëhet e nevojshme. Këshilluesi i bën me dije mësuesit që po shikon situatën nga këndvështrimi personal dhe jo si profesioniste. Ndërkohë mësuesi pranon që ka probleme në jetën personale dhe i kërkon këshillim për jetën personale. Në këtë rast këshilluesi gjendet në një çështje etike ku i duhet të tregojë kujdes në trajtimin e saj. Në varësi të profesionit, çdo punonjës në shkolat fillore kanë kodin e tyre të etikës siç janë edhe kodet e këshilluesve në amerikë (American Association for Counseling and Development dhe The National Board for Certified Counselors).[5] Ata mund të udhëzohen dhe bazohen në këto kode për të trajtuar çështjet, por që vendimi përfundimtar u ngelet atyre si këshillues. Vlerat e tyre janë një element shumë i rëndësishëm që ata marrin në konsideratë deri diku dhe kanë një ndikimtë fortë në sjelljen e tyre këshilluese. Çështjet etike nganjëherë varen nga shkalla në të cilën ata lejojnë vlerat e tyre të përcaktojnë veprimet e tyre kur këshillojnë. Dhe kur kjo shkallë është e lartë atëherë ata përballen me deprivimin e të drejtave të klientëve të tyre.

Fokusi i marrëdhënies së këshillimit duhet të jetë tek çështjet që kanë të bëjnë me punën, pra specifikisht me problemin e klientit.[6] Marrëdhënia trepalëshe e këshillimit (konsulent-i konsultuar-marrëdhënia me klientin) e bën natyrën e konsultimit më komplekse sesa natyra këshilluese. Kur këshillojnë, këshilluesit e shkollave fillore, duhet të shmangin marrëdhëniet me role të dyfishta me

---

[3] Ethic and the Early Childhood Educator.
[4] Dougherty, 1990.
[5] Elementary school guidence and counseling/ February 1992/ VOL.26
[6] The code of American Association for Counseling and Development, 1988.

klientët e tyre. Për shëmbull, një këshillues luan dy role në një marrëdhënie me një mësues, pra këshillues dhe konsultues.[7] Çështjet etike që rrjedhin nga marrëdhëniet e konsultimit rrotullohen rreth çështjeve me fokus punën, marrëdhënieve të dyfishta dhe lirisë në zgjedhje. Në rastin e mësuesve në shkolla, këshilluesit me të drejtë u japin sugjerime dhe i udhëzojnë drejt praktikave të duhura me nxënësit, por u japin lirinë e tyre për të zgjedhur se si do të veprojnë. Në çdo kërkim shkencor në fusha të ndryshme si fillim merren në konsiderat çështjet etike, kodet që kujdesen për to dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave që nxirren nga studimi.

Sipas shkencës dhe teknologjisë etika është një grup rregullash që mund të quhen ndryshe vlera morale. Në kohët e fundit vërehet dobësimi i vlerave etike dhe konsideratave etike në prezantimet shkencore, fakt ky që ka të bëjë me rritjen e kauzave dhe çështjeve etike.[8] Kohëve të fundit për shkak të gjendjes pandemike që po përjetojmë shumë studime dhe kërkime shkencore janë zhvilluar online përmes Internetit. Nga kjo është konstatuar që ka pasur disa çështje etike përgjatë këtij procesi, për vetë faktin se është më e vështirë të mbash si proces nën kontroll përsa u përket shpërndarjes së të dhënave konfidenciale, publikimin e tyre, gabimet në përpunime etj, duke çuar kështu në çështje etike.

Çështjet etike organizacionale trajtohen në një mënyrë tjetër duke bërë si fillim identifikimin e çështjeve etike dhe procesin e vendimarrjes, duke e konkretizuar situatën me një frazë të shkurtër dhë duke përcaktuar në mënyrë më të mirë të mundshme hapat për procesin e zgjidhjes së kësaj situate. Së dyti, studiohen faktet që kemi në dispozicion, kompleksitetin e situatës, prespektivën e target-grupit, të dhënat si dhe burimet njerëzore dhe financiare. Së treti, selektimi i opsioneve më të mira të mundshme për zgjidhjen e situatës. Së katërti, kuptimi i vlerave dhe detyrave në këtë situatë, standardet dhe parimet profesionale. Së pesti, vlerësimi i atyre opsioneve se cili është i duhuri për këtë çështje, duke parë çfarë ndikimesh do të ketë, çfarë përfitimesh kanë palët dhe nëse merr përgjigje pyetja që kemi. Së

[7] Kitchener, 1988.
[8] E,F. Schumacher. A guide for the Perplexed. 1977. p.65

gjashti, kemi edhe rishikimin e planit, nëse opsioni ka qenë i efektshëm, ka pasur rezultate të mira etj.[9]

Sipas një artikulli që sjell çështjet etike në kriminologji, termi etikë i referohet grupeve të parimeve që rregullojnë sjelljen. Çështjet etike klasike që trajton janë përgjithësisht në lidhje me mbrojtjen e njerëzve, cënimin e privacisë, konfidencialiteti i regjistrimeve dhe intervistave, aksesi në të dhëna dhe imuniteti i kërkuesve nga ndjekja penale.[10] Janë disa raste që tregojnë se si stilet e kërkimit rrisin çështjet etike klasike. Ndër to mund të përmendim:

> *"Një shkencëtar politik të Harvardit që ishte i pari që u burgos për moszbulimin e burimeve konfidenciale të informacionit rreth lëshimit të paautorizuar të Pentagon Papers. Kur refuzoi t'i tregonte ato para gjykatës kur u shfaq për tetë orë, ai u mbajt në burg për një javë derisa juria u shkarkua."*[11]

Një arsye shtesë për vendosjen e një prioriteti të lartë ndaj konsensusit etik në drejtësinë penale është se njerëzit e përpunuar nga ai sistem ka të ngjarë të jenë të varfër ose pakicë dhe kështu të kenë pak akses në mjetet konvencionale për të paraqitur ankesat e tyre. Kërkimi shkencor dhe etika janë të ndërlidhura, sidomos në drejtësinë penale. Çështjet etike në drejtësi në ditët e sotme janë më ndryshe nga ato që kishte nxjerrë në pah Aristoteli, Plato, Kant etj. Shkenca sot është më e kuptueshme nga një brez demografik i fshirë nga e sotmja. Për të rrjetizuar të dyja është një problem i joni mijëravjeçarë që nuk po i japim zgjidhje.

Në një artikull shkencor trajtohen dhe çështjet etike në përfaqësimin e personave me aftësi të veçanta dhe këto çështje janë të padiskutuara. Kanunet këshillojnë avokatët të prezantojnë klientët zellshëm brenda ligjit dhe të zbulojnë objektivat e ligjshme të klientëve por janë të heshtur përsa i përket disa implikimeve etike të riprizantimit të klientëve të paaftë.[12] Çështjet etike që janë rritur shërbejnë për të

---

[9] College of Physiotherapists of Ontario, Ethics Module.
[10] Marvin E. Wolfgang, VOL.72, pg. 2
[11] Nejelski & Finsterbusch, The prosecutor and the researcher. 1973.
[12] Code of Professional Responsibility Canon 7, 1979.

shkaktuar çështje që gjykatësit dhe juria nuk pëlqejnë të konfrontohen. Çështjet etike janë përfshirë dhe në riprezantimin e personave të paaftë mendorë dhe Komisioni i vlerësimit të standardeve profesionale, rregullat e të cilit përmbajnë të rimenduarit e premisave etike dhe problemeve të profesionit të avokatëve konkretisht.[13] Bazuar po aty, kur aftësia e klientit për të marrë një vendim adekuat të konsideruar që është e lidhur me përfaqësimin është e dëmtuar për shkak të mentalitetit, paaftësisë mendore etj, avokati duhet mundësisht një raport normal klient-avokat. Gjithashtu duhet të sigurojë një takim me një përson që do i adresojë nevojat e klientit në rast se është i paaftë për të komunikuar dhe gjykuar drejtë ose merr një urdhër mbrojtje në respekt të klientit. Në rastin konkret të një raporti mes një psikiatri dhe një të dënuari, hasen çështje etike për profesionistin. Psikiatri nuk duhet të zbulojë të dhënat e marra nga seancat me të dënuarin, por kjo në pothuajse të gjitha rastet shkelet pasi, psikiatri duhet patjetër t'i paraqesi ato në gjykatë për efekt prove të gjendjes mendore të të dënuarit.[14] Një tjetër situatë kur lindë një çështje etike mes klientit dhe psikiatrit është në momentin kur ky i fundit e inkurajon klientin që të tregojë "çdo gjë që ka në mendjen e tij". Ky fakt e bën më të ndërlikuar situatën nëse klienti vërtët nisë të flasë rreth ngjarjeve që i kanë ndodhur. Në një moment kulminant etik është kur klienti mund të shprehet se ka kryer disa vrasje, atëherë bie përgjegjësia në profesionistin që ta kallzojë rastin në polici apo të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që i jep klienti. Prandaj janë kodet etike që udhëzojnë profesionistë që çdo shprehi që zotërojnë ta përdorin në mënyrën dhe kohën e duhur.

Fatkeqësisht, sjellja e keqe e punonjësve nuk është e pazakontë. Punëtorët e pakënaqur shkelin kodet e sjelljes së kompanive të tyre gjatë gjithë kohës. Qoftë duke keqpërdorur kohën e kompanisë, duke marrë merita për punën e të tjerëve ose duke ngacmuar kolegët e tyre, pra punonjësit e pakënaqur ngrenë shumë çështje etike në vendin e punës. Pavarësisht përhapjes së një sjelljeje të tillë, sjellja e

[13] American Bar Association
[14] Estelle v. Smith, 451 U.S

keqe e punonjësve ndonjëherë nuk raportohet për një sërë arsyesh. Kolegët mund të ndihen të kërcënuar nga kolegët e tyre të paskrupullt, ose mund të kenë frikë nga reagimi i ashpër për "përleshje". Sido që të jetë, sjellja e keqe shkakton një përçarje të madhe në vendet e punës.[15]

Sipas një ankete të zhvilluar në SHBA përfundimet e nxjerra tregojnë se 49% e punonjësve të SHBA-së kanë qenë dëshmitarë të sjelljes së keqe që ka shkelur standardet etike të organizatës së tyre. Normat e raportimit të sjelljes jo etike janë rritur në nivelin më të lartë historik prej 86%. Fatkeqësisht, normat e hakmarrjes janë rritur së bashku me rritjen e raportimit me 79% të punonjësve amerikanë që raportojnë hakmarrje.[16] Pra, çfarë mund të bëjnë punëdhënësit për të zbutur sjelljen jo etike të punonjësve duke lehtësuar frikën e hakmarrjes për ata që e dëshmojnë atë? Ndërsa nuk ka një përgjigje të thjeshtë, ka disa metoda për të adresuar çështjet etike në vendin e punës. Pasi menaxherët të zbatojnë një sistem të trajtimit të çështjeve etike në vendin e punës, të gjithë duhet t'i përmbahen politikës saktësisht ashtu siç detajohet. Kur punonjësit nënshkruajnë politikën e re, duke treguar mirëkuptimin e tyre dhe duke u zotuar për pajtueshmërinë e tyre, ata pranojnë të mbajnë veten në një standard më të lartë dhe të përballen me pasojat e mosveprimit. Punëdhënësit duhet të bien dakord që t'i përmbahen të njëjtit standard. Kemi shumë raste të tilla në fushën e biznesit që ndoshta dhe pavetëdije apo nga mundesa e informacionit të punonjësve po kthehen në çështje etike në vendet e punës.

Kur një aktivitet në një mjedis biznesi bie ndesh me parimet morale njerëzore dhe prek individët e përfshirë që punojnë brenda organizatës, ai bëhet një çështje etike. Edhe pse rregullat e vendosura nga qeveria mund t'i mbajnë punonjësit dhe punëdhënësit përgjegjës për sjellje që shkelin ligjin, ato nuk mund t'i parandalojnë plotësisht individët që të veprojnë në mënyrë joetike. Prandaj, është përgjegjësia e pronarit të biznesit që të adresojë shqetësimet etike dhe të vendosi udhëzime të qarta se çfarë sjellje është dhe çfarë nuk është e lejueshme në vendin e punës. Sjellje jo etike siç është dhe diskriminimi nga

---

[15] The Global Bussines Ethics Survey
[16] Ethics & Compliance Initiative (ECI)

punëdhënësi apo dhe kolegët mes njëri-tjetrit në vendin e punës janë bërë problematike.[17]

Një kornizë tike është si mbajtëse për veprimin e përbërë nga filozofia morale, kodet profesionale të sjelljes, vlerat e natyrshme në modelet terapeutike, etika personale, ligji, konteksti organizativ etj.[18] Janë disa parime etike në marrjen e vendimeve si psh: detyrat absolute të Kant, teoritë e ndikimit dhe teoria virtytit. Në të gjitha profesionet bëhen gabime. Ajo se çfarë është e rëndësishme është që njerëzit të bëjnë më të mirën e mundshme dhe të japin njohuritë dhe aftësitë që zotërojnë bazuar në parimet etike, kodet dhe procedurat ligjore.[19]

Çështjet etike nuk janë thjesht në vendet e punës apo në shtete të caktuara, por dhe në organizatat e mëdha që operojnë në bazë globale. Ato përballen me sfida të vështira etike për shkak të një sërë faktorësh ekonomikë, kulturorë, politikë, teknologjikë dhë të tregut. Sa më i madh të jetë kompleksiteti i mjedisit, aq më i lartë është potenciali për probleme etike dhe keqkuptime për organizatat globale. Disa çështje etike që po përballen së fundmi organizatat globale janë: kiberniteti, kërcenimet politike, korrupsioni, paqëndrushmëria politike, të drejtat e njerëzve dhe diversitetin.[20] Sistemet e vlerave etike bënin të mundur "mprehjen" e sjelljes brenda dhe jashtë vendeve të botës.

Si në çdo profesion tjetër edhe në infermieri vërehen çështje etike, vlerat kontradiktore dhe paqartësi në marrjen e vendimeve. Për shkak të mungesës së qartësisë në standardet etike, infermierët duhet të zhvillojnë një ndërgjegjësim në lidhje me këto çështje. Kjo është e nevojshme për të pajtuar vlerat etike të infermierëve me të drejtat që ka secili nga pacientët. Kodet profesionale, ligjet, rregulloret dhe komitetet e etikës ofrojnë udhëzime, por përcaktuesi kryesor sesi zhvillohet ky proces i zgjidhjes së çështjeve etike janë sistemi i vlerave dhe kodi i etikës së profesionistit. [21] Ndodh që dhe në mjediset e punës infermierët në këtë rast të hasin ngatërresa detyrash, mbingarkesë roli apo dhe përplasje parimesh

[17] Fair Work Ombudsman, 2021
[18] Bond, 2008
[19] Scaife, J. (2001). p.130
[20] Joseph W. Weiss, Bentley University, Waltham, MA. 2014.
[21] Johnstone M. Bioethics. A . Nursing Perspective. 5th edition Churchil Livingstone Elsevier, 2009.

etike me kolegët apo supervizorët e tyre.

Në përfundim mund të them se etika është një element shumë i rëndësishëm në punën e çdo profesionisti dhe punëdhënësit, organizata apo institucioni ku ata ushtrojnë profesionin duhet patjetër të zotërojnë një kod etikë në bazë të të cilit veprojnë punonjësit në rastin e përballjes me një çështje etike në vendin e punës. Të qënit të përpiktë në zbatimin e këtij kodi etik mund të parandalojë edhe çështjet etike e jo vetëm t'u japi zgjidhje atyre. Janë kryer shumë studime nga studiues të ndryshëm që pohojnë faktin që kodi etik është i domosdoshëm në çdo institucion për mbarëvajtjen dhe funksionimin e mirë të çdo punonjësi. Kjo në fakt sjellë dhe rezultate të mira në punë dhe punonjës të kënaqur me atë që bëjnë. Nëse punonjësit do të njiheshin që në fillimet e tyre me këto rregulla dhe kode do e kenë më të lehtë përballjen me to. Në secilën prej fushat e përmendura më lart (sjell përmes shembujve të marrë nga artikuj shkencorë të punuar në shtete të ndryshme) na lë të kuptojmë se hasja në çështje dhe dilema etike është e pashmangshme, kjo për shkak të përplasjes së vlerave të punonjësve apo keqkomunikimit me punëdhënësit.

BIBLIOGRAFIA

1. Bresler, L. (1995). Ethical Issues in Qualitative Research Methodology. *Bulletin of the Council for Research in Music Education*, *126*, 29–41. http://www.jstor.org/stable/40318732
2. DeLorme, D. E., Zinkhan, G. M., & French, W. (2001). Ethics and the Internet: Issues Associated with Qualitative Research. *Journal of Business Ethics*, *33*(4), 271–286. http://www.jstor.org/stable/25074610
3. Dougherty, A. M. (1992). *Ethical issues in consultation.* Elementary School Guidance & Counseling, 26(3), 214–220. http://www.jstor.org/stable/42869017
4. Ethics around the globe. Principles of Management. BCcampus. https://opentextbc.ca/principlesofmanagementopenstax/chapter/ethics-around-the-globe/#ch05rfin-66
5. Fathima, A. (2021). *Ethical Issues in Business: what are they and how to handle them?* Zoho TTDU. https://www.zoho.com/au/tech-talk/ethical-issues-in-business.html
6. Feeney, S., & Freeman, N. K. (2016). *Ethical Issues: Responsibilities and Dilemmas.* YC Young Children, 71(1), 86–89. http://www.jstor.org/stable/ycyoungchildren.71.1.86
7. Fouka, G & Mantzorou, M. *What are the major ethical issues in conducting research?* Health Science Journal. https://www.hsj.gr/medicine/what-are-the-major-ethical-issues-in-conducting-research-is-there-a-conflict-between-the-research-ethics-and-the-nature-of-nursing.php?aid=3485

8. GOLSHANI, M. (2003). Values and Ethical Issues in Science and Technology: A Muslim Perspective. *Islamic Studies*, *42*(2), 317–330. http://www.jstor.org/stable/20837273
9. Hernberg, S. (1995). Ethics in research. *Scandinavian Journal of Work, Environment & Health*, *21*(4), 241–243. http://www.jstor.org/stable/40966401
10. How to Address Ethical Issues in the Workplace. (October 26, 2021). Texas A&M University CORPUS CHRISTI. https://online.tamucc.edu/degrees/business/mba/general/how-to-address-ethical-issues-in-the-workplace
11. Perlin, M. L., & Sadoff, R. L. (1982). *Ethical Issues in the Representation of Individuals in the Commitment Process.* Law and Contemporary Problems, *45*(3), 161–192. https://www.jstor.org/stable/1191247
12. Physiopedia. *Identifying and Analysing an Ethical Issue.* 2010. https://www.physiopedia.com/Identifying_and_Analysing_an_Ethical_Issue
13. Trevino, L. K. (1986). *Ethical Decision Making in Organizations: A Person-Situation Interactionist Model.* The Academy of Management Review, 11(3), 601–617. https://www.jstor.org/stable/258313
14. Walsh, S. (March 2018). *Proffessional and Ethical Issues.* ISW. University of Sheffield. https://www.sheffield.ac.uk/polopoly_fs/1.785016!/file/Day2_ProfessionalandEthicalIssues_SWalsh2018.pptx.pdf
15. Wolfgang, M. E. (1981). *Confidentiality in Criminological Research and Other Ethical Issues.* The Journal of Criminal Law and Criminology *(1973-)*, *72*(1), 345–361. https://www.jstor.org/stable/1142913